



REPUBLIKA E SHQIPERISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR

TIRANE

Nr. 3122/375/644 Rregj. Them

Nr. 582 Vendimi

Data regj. 26.11.2021/24.01.2022

Data vendimit 04.03.2022

VENDIM

NE EMER TE REPUBLIKES

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e përbërë nga:

Gjyqtar: LAZER SALLAKU

Asistuar nga sekretar gjyqësore **Rei Peçi**, me pjesmarrjen e **prokurorit Ylli Bashaj**, sot me dt. **04.03.2022**, në Tiranë, mori në shqyrtim ne seancë gjyqësore me dyer te mbyllura, qe i perket:

KERKUES: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tirane

OBJEKTI: Dergim i çështjes ne gjykim.

I PANDEHUR: Anteo Guci identifikuar me pasaporten biometrike I30417176K i biri i Petrit dhe Qerime i dtl 17.04.1983 lindur ne Tepelene dhe banues ne Tirane, Astir, Unaze e Re, rruga “Tom Plezha” pallati numer 1, kati 7, hyrja 42, arsim i mesem, i martuar me 2 femije shtetesi shqiptare, i padenuar, me mase sigurimi “Arrest ne shtepi”, mbrojtur nga av. Brunela Kullolli.

AKUZUAR: “Prodhimi dhe shitja e narkotikeve”, “Mbajtje pa leje dhe prodhimi i armeve, armeve shperthyese dhe i municionit” parashikuar nga neni 283/1 dhe 278/3/4 i K.Penal.

Gjykata, pasi shqyrtoi çështjen me gjykim të shkurtuar, dëgjoi Prokurorin e çështjes Ylli Bashaj, i cila në diskutimet perfundimtare kerkoi:

Te deklarohet fajtor i pandehuri Anteo Guci, per veprat penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikeve”, parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal dhe te “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armeve, armeve shperthyese dhe i municionit”, parashikuar nga neni 278/2/3 i K.Penal dhe denimin e tij me burgim.

Avokatja përfundimisht kërkoi: Deklarimin fajtor te te pandehurit per kryerjen e vepres penale “Prodhim dhe shitje se narkotikeve” parashikuar nga neni 283/1 dhe 278/2/3 i K.Penal dhe denimin e tij ne minimum.

Ne aplikim te nenit 406/1 i K.Penal, i ulet 1/3 e denimit.

Aplikimin e nenit 59 te K.Penal, pezullimin e ekzekutimit te vendimit me burgim dhe venien ne prove per pjesen e mbetur per shtetasin Anteo Guci.

I pandehuri përfundimisht kërkoi: Jam dakort me avokaten.

Gjykata, pasi shqyrtoj çështjen në tërësi:

VEREN

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka sjellë për gjykim çështjen penale në ngarkim të pandehurit **Anteo Guci** akuzuar për veprat penale të “**Prodhimi dhe shitja e narkotikeve**”, “**Mbajtje pa leje dhe prodhimi i armeve, armeve shperthyese dhe i municionit**” parashikuar nga **neni 283/1 dhe 278/3/4 i K.Penal.**

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale te paraqitur për gjykim bazuar në nenin 69 të K.Pr.Penale, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet të realizohet përpara kësaj gjykate.

Po kështu kjo çështje në baze të neneve 13 dhe 74 të K.Pr.Penale, është në kompetencën lëndore të kësaj gjykate, pasi vepra penale për të cilën është proceduar i pandehuri gjykohet me trup gjykues të përbërë nga një gjyqtar.

Përsa i përket kompetencës tokësore, ajo përcaktohet shprehimisht në nenin 76 të K.Pr.Penale ku citohet se: “*Kompetenca tokësore përcaktohet, me rradhë, nga vendi ku është kryer ose tentohet të kryhet vepra penale ose vendi ku ka ardhur pasoja*”. Përsa me sipër, përderisa vepra penale dyshohet se është kryer në Tiranë, kompetente për nga territori është kjo gjykate.

Gjithashtu, Gjykata në veshtrim të neneve 13,15,16,17,18 të K.Pr.Penale, çmoi se nuk ekzistojnë shkaqe papajtueshmërie ose përjashtimi nga ky gjykim, fakt ky i pakundershtuar edhe nga palet pasi u prezantua përberja e trupit gjykues.

Gjykata konstaton se, në zbatim të nenit 332/c të K.Pr.Penale të ndryshuar ky nen me nenin 17/2 të ligjit 41/2021 nën titullin “Zhvillimi i seancës” i pandehuri kërkoj në seancë paraprake gjykim të shkurtuar dhe në bazë të kësaj dispozite, Gjykata ftoi palët të paraqesin diskutimet përfundimtare, pasi kreu verifikimin mbi gjendjen e akteve, sipas parashikimeve të nenit 332/c të këtij Kodi dhe pasi pranoi kërkesën për gjykim të shkurtuar.

Rrethanat e faktit.

Nga aktet e shqyrtuara në seancë gjyqësore me gjykim të shkurtuar, rezulton plotësisht e provuar se me datën 05.08.2021, rreth orës 23:11, në rrugën "Besim Alla ", një grup punonjësish të strukturës policore të seksionit të luftës kundër narkotikëve, strukturë pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, kanë vënë re e ndaluar automjetin tip Citroen C3, me targa AA6630X, drejtues i të cilit ishte i pandehuri Anteo Guci. Pas ndalimit, pjesëtarët e grupit, janë afruar pranë tij, i janë prezantuar si punonjës policie dhe kanë vënë në dijeni se do të kryenin kontrollin e autoveturës së drejtuar prej tij. Nga kontrolli i automjetit, veprim ky i kryer në kushtet e flagrancës, në dyshemene e tij, në vendin poshtë ndenjësës së shoferit, ku vendosen kembët, është gjetur një paketim metalik, brenda të cilit ishin vendosur 10 (dhjetë) qese të vogla plastike, në blu dhe të verdhë, brenda të cilave kishte material pluhuri në ngjyrë të bardhë, i ngjashëm me atë të lëndës narkotike të llojit kokainë.

Gjetja e kësaj sasive, ka nxitur anëtarët e grupit për të bërë edhe kontrollin në kushtet e flagrancës edhe të banesës së pandehurit Anteo Guci. Gjate kontrollit, brenda janë gjetur një armë zjarri e llojit pistoletë, me mbishkrimin "Bloë Mind 2003, Nr. 6-221180 Cal 8 mm, 37 (tridhjetë e shtatë) fishekë luftarake, 2 (dy) pranga të metalike, 5 (pesë) kapsolla detonatore për granata, 1 (një) peshore elektronike në ngjyrë të zezë me mbetje lende të dyshuar narkotike kokaine, 1 (një) kreher pistolette.

Në vijim, gjatë kontrollit të mjetit tip motor, me targa AR690, në përdorim të shtetasit Anteo Guci, në pjesën e brendshme të koshit të tij, është gjetur një peshore elektronike në ngjyrë të zezë, me butona, me mbetje lënde të dyshuar narkotike kokainë. Sendet e konsideruara si prova prova material janë sekuestruar me një cilësi të tillë dhe i pandehuri është shoqëruar në organin e policisë, ku edhe është bërë arrestimi i tij në flagrance.

Konkluzionet e aktit të ekspertimit tekniko balistik armë zjarri Nr 8295 të datës 24.08.2021 tregojnë se, arma e zjarrit objekt ekspertimi me numer 6-221180 e markes BLOË MINI MOD 2003, e sekuestruar shtetasit Anteo Guci, është arma zjarri pistoletë, e kalibrit 6,35 mm, që përdor si municion fishke standarte luftarake të fabrikuar kaliber 6,35 mm. Në gjendjen që paraqitet është e përshtatshme për qitje.

Konkluzionet e aktit të ekspertimit tekniko balistik të provave materiale me Nr 345 të datës 16.08.2021 tregojnë se, municionet prej tridhjetë e shtatë copë fishekët objekt ekspertimi, janë fishekë luftarake model sportiv, të llojit të gjatë dhe të fabrikuar me kaliber 5,6 mm, të cilët përdoren si municion për gjitha armët e zjarrit sportive, pistoletat e këtij kalibri dhe janë në gjendje të rregullt dhe të përshtatshëm për qitje. Fishekët janë të ndryshëm në kalibër me atë të armës së zjarrit të sipërcituar.

Ndërsa konkluzionet e aktit të ekspertimit tekniko balistik të provave materiale me Nr 346 të datës 16.08.2021 tregojnë se, pesë copë ndezësa objekt ekspertimi, janë ndezës të unifikuar të granatave të dorës, të cilat përdoren në granatat e luftimit mbrojtës e mësymës. Keta pesë copë ndezës të unifikuar, në gjendjen që paraqiten janë teknikisht të parregullt. Per rrjedhoje ndezesat e kanë humbur aftësinë shpërthyesë apo eksploduese.

Nga konkluzionet e aktit të ekspertimit kimik të lendes Nr 10986 të datës 27.10.2021, tregohet se, pesha pa ambalazh e materialeve të numërtuara nga 1-10, që i janë sekuestruar shtetasit Anteo Guci, është në total 4,767 gramë dhe analiza me GC/MS për materialin objekt ekspertimi, tregoi për praninë e kokainës. Analiza me GC/MS për mbetjet në peshoren objekt ekspertimi treguan për praninë e kokainës. Analiza me GC/MS për mbetjet në kartën objekt ekspertimi treguan për praninë e kokainës.

Të dhënat e aktit të ekspertimit toksikologjiko-ligjor Nr 2028 i datës 26.08.2021 i personit në hetim Anteo Guci, tregojnë se, në mostrën e urinës së shtetasit në fjalë, nuk u zbulua prania e produkteve të metabolizmit të Cocainës në organizmin e njeriut.

Vlerësimi i Gjykatës.

Përsa i përket **kualifikimit ligjor** të fakteve të parashtruara më sipër Gjykata vëren se, **neni 283/1 i K.Penal** parashikon:

“Shitja, ofrimi për shitje, dhënia ose marrja në çdo formë, shpërndarja, tregtimi, transportimi, dërgimi, dorëzimi, si dhe mbajtja, përveç rastit të përdorimit vetjak dhe në doza të vogla, të substancave narkotike dhe psikotrope, si edhe i farërave të bimëve narkotike, në kundërshtim me ligjin ose në kapërcim të përmbajtjes së tyre, dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet.

Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.

Organizimi, drejtimi apo financimi i kësaj veprimtarie, dënohen me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet.”.

Objekti i veprës penale **“Prodhimi dhe Shitja e Narkotikëve”** të parashikuar nga neni **283/1 i Kodit Penal** mund të trajtohet si i dyfishtë, në objekt parësor dhe në objekt dytësor. Objekti parësor janë marrëdhëniet juridike që garantojnë shitjen, blerjen, shpërndarjen transportimin, mbajtjen dhe përdorimin sipas dispozitave ligjore përkatëse të lëndëve narkotike e psikotrope, nga veprime të kundra ligjshme e shoqërisht të rrezikshme, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në shëndetin e personit, funksionimin normal të veprimtarisë së organeve jetësore të tij. Kjo dispozitë përjashton nga përgjegjësia personale përdoruesit e lëndëve narkotike duke përcaktuar si kritere mbajtjen në doza të vogla, ndërsa përgjigjen penalisht pavarësisht se është përdorim vetjak kur sasia e mbajtur është e madhe. Qëllimi i ligjvënësit në përjashtimin e përdoruesve ka qenë duke i parë ata si viktimë të veprës penale dhe jo si subjekte të kryerjes së saj.

Ndërsa objekti dytësor i kësaj vepre penale janë marrëdhëniet juridike të vendosura nga ligji për të garantuar paprekshmërinë e rendit dhe qetësisë publike, jetës dhe shëndetit të njeriut. Kjo tërësi marrëdhëniesh juridike dhe jo vetëm janë të mirat publike dhe të tërë shoqërisë që justifikojnë dhe përligjin ekzistencën e legjislacionit penal. Në rastin konkret, ka prova të mjaftueshme se ky objekt është cenuar nga i pandehuri **Anteo Guci**, pasi me veprimet e tij të drejtpërdrejta dhe të vullnetshme, veprime të cilat do t’i analizojmë më poshtë në analizë të anës objektive dhe subjektive të kësaj figure krimi, i pandehuri e ka kryer veprën penale.

Në lidhje me anën objektive të figurës së veprës penale, në kuptim të nenit **283/1 të Kodit Penal**, duhet që i pandehuri të kryejë njërën prej veprimeve aktive që dispozita e mësipërme liston në mënyrë kufizuese dhe të mbyllur. Këto s’janë gjë tjetër veçse figurat konkrete të veprës penale mëmë që është **“Prodhimi dhe Shitja e Narkotikëve”**. Për shembull, ai duhet t’a shesë atë. **Shitja**, në rastin konkret, është dhënia e lëndës narkotike, të substancave narkotike, lëndëve psikotrope apo i farërave të bimëve narkotike një tjetri kundrejt çmimit, të çfarëdo sasive qoftë por e kufizuar kjo në një veprim konkret apo e shumta në disa veprime pa një lidhje të qëndrueshme, pa një mendim unik e vazhdueshme kriminal, e me frekuenca jo të rregullta të ndodhjes së saj. Për qëllime të ligjit do të mjaftonte një transaksion i tillë për ta quajtur të konsumuar këtë figurë të veprës penale. Shitja si koncept juridik edhe mund të huazohet nga e drejta civile, për t’u kuptuar si natyrë veprimi juridik në këtë rast, por nuk do të mund të shkonte logjika referuese më tej, pasi, sigurisht, që në rastin konkret flasim për një veprim absolutisht të pavlefshëm, pasi sendi i kontraktuar ndalohet të qarkullojë civilisht dhe si i tillë veprimi juridik ndalohet nga ligji.

Ofrimi për shitje është shfaqja e vullnetit në mënyrë të padyshimtë të poseduesit të lëndës narkotike, substancave narkotike, lëndëve psikotrope apo farërave të bimëve narkotike dikujt për ta shitur atë. Kjo figurë vepre penale dhe kjo shfaqje e vullnetit mund të ndodhë me çdo veprim të mundshëm komunikimi, qoftë edhe me veprime konkludente. Vetëm shfaqja e vullnetit të poseduesit të lëndës ligjërisht të ndaluar do të jetë e nevojshme dhe e domosdoshme për të patur këtë figurë vepre penale.

Dhënia ose marrja në çdo formë si figurë konkrete e veprës penale mëmë synon të përfshijë të gjitha llojet e veprimeve që kalojnë posedimin e lëndës narkotike, substancave narkotike, lëndëve psikotrope apo farërave të bimëve narkotike, të pa përfshira në dispozitë, p.sh. shkëmbimi, dhurimi etj. Edhe në këtë rast do të jemi në të njëjtën logjikë juridike të rasteve të mësipërme, që do të thotë se veprimi kriminal konkret ndodh një herë apo edhe disa herë por pa u bërë qëllim në vetvete dhe mjaftueshëm i shkëputur në kohë sa për të mos u ravijëzuar si veprimtari e vazhdueshme apo e qëndrueshme kriminale.

Transportimi si një prej figurave konkrete konsumohet duke u realizuar zhvendosja e lëndës narkotike nga një vend në një vend tjetër pa qenë nevoja për veprime të tjera. **Dërgimi** është figurë mjaft e ngjashme me transportimin e lëndës narkotike veçse karakterizohet nga një instensitet më i ulët fizik i zhvendosjes së saj. Dërgimi është një formë e ndërmjetme midis transportimit dhe dorëzimit si figura të veçanta kriminale. **Dorëzimi** është veprimi fizik i lënies së lëndës narkotike, substancave narkotike, lëndëve psikotrope apo farërave të bimëve narkotike në destinacionin e porositur.

Mbajtja është posedimi i qëndrueshëm dhe latent i lëndës narkotike, substancave narkotike, lëndëve psikotrope apo farërave të bimëve narkotike nga një subjekt në vende të caktuara për këtë qëllim, me qëllim për ta ofruar, shpërndarë, transportuar, dorëzuar, dërguar, tregtuar apo për ta dhënë në çdo formë kundrejt një subjekti tjetër. Megjithëse qëllimi nuk është i shprehur në dispozitë, Gjykata çmon se vetëm në të tillë mënyrë interpretimi kjo figurë konkrete e veprës penale shfaq veprimtari që karakterizohet nga rrezikshmëria shoqërore. Megjithatë Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë pranuar se kjo figurë vepre penale mund të quhet e konsumuar edhe pa u vërtetuar qëllimi si element i anës subjektive. Të katërta këto figura të mësipërme kanë një gjë të përbashkët, faktin se këto forma objektive kriminale janë një pjesë e aktivitetit kriminal të trafikimit apo tregtimit të lëndës narkotike, janë hallka të ndërmjetme të një veprimtarie kriminale tërësore. Në këto kushte, pavarësisht aftësisë zbuluese dhe proceduese të organeve të ndjekjes penale të shtetit, këto vepra penale gjithmonë kryhen në bashkëpunim, pasi janë pjesë e një veprimtarie të tërë.

Shpërndarja është tërësia e veprimeve fizike transportuese, dërguese, dorëzuese apo dhënie në çdo formë, në mënyrë të përsëritur të lëndës narkotike, substancave narkotike, lëndëve psikotrope apo farërave të bimëve narkotike në një apo disa pika të ndryshme. Ajo presupozon një shtrirje të qëndrueshme dhe të vazhdueshme në kohë të veprimeve të përmendura më sipër dhe për këtë arsye përbën krim latent apo vazhdues, pasi ndodh në boshtin e të njëjtit mendim unik kriminal.

Tregtimi i lëndës narkotike, substancave narkotike, lëndëve psikotrope apo farërave të bimëve narkotike, si figurë konkrete e veprës penale presupozon krijimin e një veprimtarie tregtare të subjektit aktiv të veprës penale me këto lëndë. Kryerja e shitjeve, shkëmbimeve apo e çdo veprimi tjetër me karakter tregtar, apo e çdo lloj transaksioni të mundshëm që sjell përfitime pasurore dhe që synon të kalojë posedimin e lëndës së ndaluar ligjërisht, e shtrirë në kohë në mënyrë të vazhdueshme dhe të qëndrueshme nën një mendim unik kriminal do të përbënte figurën e veprës penale të posaçme të tregtimit. Natyra e dy figurave të veprës penale të sqaruara së fundmi është e përbashkët dhe njëkohësisht dallon nga figurat e renditura më sipër për nga karakteri sporadik i ndodhjes dhe i lidhjes midis tyre. Dy figurat e fundit të veprës penale sigurisht që paraqesin rrezikshmëri shoqërore më të lartë se sa të parat për të gjitha arsyet e sqaruara më sipër.

Por kërkesat e ligjit, për t'i kualifikuar këto veprime objektive si kriminale dhe si figura të veçanta të veprës penale të prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, nuk ndalojnë këtu.

Dispozita 283 paragrafi parë është një dispozitë blanketë apo e bardhë dhe si e tillë për t'u bërë e zbatueshme kërkon domosdo ekzistencën e një ligji tjetër të cilës do t'i referohet rast pas rasti. Kështu, dispozita shprehet "... në kundërshtim me ligjin ose në kapërcim të përmbajtjes së tyre ...". Kjo do të thotë se veprimet e mësipërme aktive të subjektit aktiv të veprës penale duhet të jetë në kundërshtim me parashikimet e ligjit që rregullon regjimin juridik të lëndëve narkotike, substancave narkotike, lëndëve psikotrope apo farërave të bimëve narkotike, konkretisht të Ligjit

Nr. 7975 të datës 26.07.1995 “Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope”, i ndryshuar. Në këtë mënyrë plotësohet hipoteza e përgjithshme e ekzistencës së veprës penale dhe parashikimit të saj nga ligji (preamisa maior).

Gjykata çmon të theksojë se, krimi i prodhimit dhe shitjes së lëndëve narkotike që parashikohet në nenin 283 të Kodit Penal, përveç shitjes, ofrimit për shitje, marrjes në çdo formë, shpërndarjes, tregtimit, transportimit, dërgimit dhe dorëzimit të substancave narkotike dhe psikotrope, si dhe i farërave të bimëve narkotike, në kundërshtim me ligjin ose në kapërcim të përmbajtjes së tyre, nga ana objektive, kryhet edhe në formën e mbajtjes së këtyre lëndëve, substancave e farërave, në kundërshtim me ligjin ose në kapërcim të përmbajtjes së tyre. Lidhur me këtë formë (mbajtjen) të anës objektive të kësaj figure krimi, Ligjvënësi, si kriter përcaktues për ekzistencën e vetë figurës së krimit dhe, për pasojë, të bazës së përgjegjësisë penale për personat që e konsumojnë atë, ka parashikuar dy rrethana specifike: **së pari**, mbajtjen e substancave narkotike dhe psikotrope, si dhe të farëve të bimëve narkotike jo për përdorim vetiak dhe **së dyti**, edhe kur rezulton i provuar fakti që, këto lëndë mbahen nga personi për përdorim vetiak, në aspektin sasior, ato nuk duhet të jenë në doza të vogla. Përsa i përket rrethanës së parë, Gjykata vë në dukje se ajo është rrethanë fakti - rezultat i procesit të të provuarit nëpërmjet analizës, në zbatim të kërkesave të dispozitës së nenit 152 të Kodit të Procedurës Penale, të provave dhe indicieve, në të cilat duhet të bazohet gjykata për të arritur në përfundime të drejta, nëse lënda narkotike dhe psikotrope, etj. mbahet nga personi për përdorim vetjak apo për të kryer në vijim, ndonjërin apo disa nga veprimet e tjera të përmendura në dispozitë, që janë elementë të anës objektive të figurës së krimit të prodhimit dhe shitjes së narkotikëve. E veçanta e rrethanës **“përdorimi vetjak”** është se ajo nuk qëndron më vetë. Ajo nuk mund të shërbejë e vetme për të arritur në përfundimin se, duke u bazuar vetëm në ekzistencën e saj nuk ekziston edhe figura e krimit të parashikuar në nenin 283 të Kodit Penal. Ajo nuk mund të shërbejë e vetme për të arritur në përfundimin se nuk ekziston baza ligjore (figura e krimit) për të marrë mbajtësin e tyre në përgjegjësi penale. Përkundrazi, për të mos u marrë mbajtësi i lëndëve të tilla në përgjegjësi penale duhet të provohet se ekziston edhe rrethana e dytë, që ka lidhje me sasinë e këtyre lëndëve, e cila, sikurse shprehet ligjvënësi në vetë dispozitën e përmendur, duhet të jetë **“në doza të vogla”**. Nocioni juridiko-penal që është shprehur nga ligjvënësi me togfjalëshin **“në doza të vogla”**, edhe pse nuk mund të bëhet ndonjë përcaktim numerik i sasisë së lëndëve të ndaluara që do të shprehte në peshë sasinë e dozës për t’u konsideruar e vogël, duhet të interpretohet në kuptimin që, në aspektin sasior, lënda narkotike dhe psikotrope, etj., duhet të jetë në atë masë sa të konsiderohet realisht e vogël për përdorim vetjak nga ana e individit konkret dhe jo në përgjithësi. Ajo nuk duhet të tejkalojë aftësitë fiziko-biologjike të individit përdorues dhe brenda kufijve të tolerancës që paraqet organizmi i tij për llojin konkret të lëndës narkotike, në momentin dhe kushtet e përdorimit të kësaj lënde, për të mos krijuar tek ai efekte tej asaj shkalle që do t’i dëmtonin shëndetin. Kështu, **doza e vogël, në kuptimin ligjor të saj, konsiderohet jo ndarja fizike në disa të tilla, por sasia e lëndës apo substancës narkotike e psikotrope që ajo përmban si e tërë dhe që sipas ekspertëve vlerësohet si dozë e vogël**. Gjykata çmon se, përcaktim i tillë i nocionit **“në doza të vogla”**, për efekte të zbatimit të dispozitës së nenit 283 të Kodit Penal, veç rolit parandalues që luan për ruajtjen e shëndetit të përdoruesve dhe personave që kanë vartësi nga droga, luan dhe rolin e parandalimit të përgjithshëm në drejtim të luftës kundër fenomenit të përdorimit të kundraligjshëm të këtyre lëndëve, i cili ku gjen përhapje në përmasa të mëdha, shndërrohet në patologji sociale. Në kushtet kur tek ne ende nuk janë përcaktuar, me ligj të posaçëm apo me akte nënligjore, rastet e përdorimit të lëndëve narkotike dhe psikotrope **“në përputhje me ligjin dhe jo në kapërcim të tyre”**, përcaktimi si më sipër i

nacionit juridiko-penal “në doza të vogla” shërben edhe për ngushtimin, në një masë të arsyeshme, të hapësirave, shfrytëzimi i të cilave, në forma të padrejta, nga keqbërësit, do të ndikonte në shmangien pa të drejtë nga përgjegjësia penale të përdoruesve të lëndëve narkotike dhe psikotrope, të cilët shpesh konstatohet se janë edhe shpërndarës të këtyre lëndëve. Për shkak të njohurive të posaçme që kërkohen në fushën e toksikologjisë, gjykata për zgjidhjen e çështjes që lidhet me sasinë e lëndës narkotike të nevojshme për përdorim vetjak duhet të thërrasë në çdo rast specialistë të fushës, si toksikologë apo mjekë terapistë, mendimi shkencor i të cilëve do të shërbejë si njëri prej kriterëve ku ajo do të mbështesë arsyetimin e vendimit të saj. Por, për zgjidhjen përfundimisht të çështjes, gjykata duhet të mbështetet edhe në kriterin tjetër, me të cilin lidhet ngushtësisht ai i pari, kriter ky, që konkretizohet nëpërmjet sqarimit të rrethanave faktike të mbajtjes së sasisë konkrete të lëndës narkotike apo psikotrope nga personi konkret, nëpërmjet zbatimit të kërkesave ligjore të Kodit të Procedurës Penale që vlejnë për realizimin me sukses të procesit të të provuarit, në përgjithësi.

Në rastin konkret, me datën 05.08.2021, rreth ores 23:11, në rrugën "Besim Alla", një grup punonjësish të strukture policore të seksionit të luftës kundër narkotikëve, strukturë pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, kanë vënë re e ndaluar automjetin tip Citroen C3, me targa AA6630X, drejtues i të cilit ishte i pandehuri Anteo Guci. Pas ndalimit, pjestaret e grupit, janë afruar pranë tij, i janë prezantuar si punonjës policie dhe kanë vënë në dijeni se do të kryenin kontrollin e autoveiturës së drejtuar prej tij. Nga kontrolli i automjetit, veprim ky i kryer në kushtet e flagrancës, në dyshemene e tij, në vendin poshtë ndenjësës së shoferit, ku vendosen kembët, është gjetur një paketim metalik, brenda të cilit ishin vendosur 10 (dhjetë) qese të vogla plastike, në blu dhe të verdhë, brenda të cilave kishte material pluhuri në ngjyre të bardhë, i ngjashëm me atë të lëndës narkotike të llojit kokainë.

Nga konkluzionet e aktit të ekspertimit kimik të lëndës Nr 10986 të datës 27.10.2021, tregohet se, pesha pa ambalazh e materialeve të numëtuara nga 1-10, që i janë sekuestruar shtetasit Anteo Guci, është në total 4,767 gramë dhe analiza me GC/MS për materialin objekt ekspertimi, tregoi për praninë e kokainës. Analiza me GC/MS për mbetjet në peshoren objekt ekspertimi treguan për praninë e kokainës. Analiza me GC/MS për mbetjet në kartën objekt ekspertimi treguan për praninë e kokainës.

Të dhënat e aktit të ekspertimit toksikologjiko-ligjor Nr 2028 i datës 26.08.2021 i personit në hetim Anteo Guci, tregojnë se, në mostrën e urinës së shtetasit në fjalë, nuk u zbulua prania e produkteve të metabolizmit të Cocainës në organizmin e njeriut.

Në rastin konkret, nga ana objektive vepra penale është kryer në formën e **Mbajtjes**, e cila është posedimi i qëndrueshëm dhe latent i lëndës narkotike, substancave narkotike, lëndëve psikotrope apo farërave të bimëve narkotike nga një subjekt në vende të caktuara për këtë qëllim, me qëllim për ta ofruar, shpërndarë, transportuar, dorëzuar, dërguar, tregtuar apo për ta dhënë në çdo formë kundrejt një subjekti tjetër. Megjithatë qëllimi nuk është i shprehur në dispozitë, Gjukata çmon se vetëm në të tillë mënyrë interpretimi kjo figurë konkrete e veprës penale shfaq veprimtari që karakterizohet nga rrezikshmëria shoqërore. Megjithatë Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë pranuar se kjo figurë vepra penale mund të quhet e konsumuar edhe pa u vërtetuar qëllimi si element i anës subjektive.

Nga ana subjektive, figura e veprës penale të “*Prodhimi dhe Shitja e Narkotikëve*” parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal kërkon si formë faji dashjen e drejtëpërdrejtë. Gjithashtu, gjykata vlerëson se, ana subjektive e figurës së veprës penale zbulohet dhe qartësohet nëpërmjet anës objektive, sepse proceset e brendshme psikike dhe psikologjike jo vetëm që ngacmohen nga

faktorë të jashtëm, por edhe materializohen në veprimtarin kriminale gjatë dhe nëpërmjet procesit të zhvillimit të anës objektive. Prandaj, për të përcaktuar anën subjektive në çështjen objekt gjykimi, gjykata do të analizojë veprimet e të pandehurit. Kështu, në plotësim të këtij elementi gjykata çmon se i pandehuri **Anteo Guci**, ka vepruar me dashje të drejtpërdrejtë, pasi ai ka parashikuar karakterin shoqërisht të rrezikshëm të veprimeve të tij dhe ka vepruar në mënyrë të kundërligjshme e të vullnetshme, duke mbajtur në mënyrë të kundërligjshme lëndë narkotike të llojit “Cocaine”.

Në lidhje me subjektin e veprës penale, gjykata vlerëson se në rastin konkret plotësohet ky element, duke pasur parasysh nenin 12 të Kodit Penal, ku thuhet se *“Ka përgjegjësi penale personi që në kohën e kryerjes së një krimi ka mbushur moshën katërmëdhjetë vjeç. Personi që kryen një kundërvajtje penale ka përgjegjësi kur ka mbushur moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç”*. Kështu, personi fizik që të konsiderohet subjekt i figurës së veprës penale, dhe si rrjedhojë të plotësojë kushtin paraprak për fajin dhe përgjegjësinë penale, duhet të plotësojë dy kritere ekskluzive ligjore (*condicio sine qua non*): Të ketë mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe të jetë i përgjegjshëm. Kështu, neni 17 i Kodit Penal parashikon se: *“Nuk ka përgjegjësi penale personi që në kohën e kryerjes së veprës vuante nga një turbullim psikik ose neuropsikik që ka prishur tërësisht ekuilibrin e tij mendor dhe për pasojë nuk ka qënë në gjëndje të kontrollojë veprimet apo mosveprimet e tij dhe as të kuptojë se kryen vepër penale”* Ky kusht ka të bëjë me domosdoshmërinë për të proceduar penalisht vetëm personat e përgjegjshëm, që kanë të paktën një ndërgjegje minimale sa për t’i bërë ato të aftë të kuptojnë rëndësinë e veprimeve që kryejnë, në mënyrë që realisht të ekzistojë ana subjektive e autorit të veprës penale, që për organin procedues do të thotë të jetë i mundur të identifikohet forma e fajësisë. Megjithatë, që të përjashtohet nga përgjegjësia penale, për shkak të gjëndjes mendore, duhet të plotësohen në mënyrë kumulative disa kushte. **Së pari**: personi të vuajë nga një turbullim psikik ose neuropsikik. **Së dyti**: ky turbullim të ketë prishur tërësisht ekuilibrin mendor të personit. **Së treti**: turbullimi të ketë ekzistuar në kohën e kryerjes së veprës. Ky kusht buron nga rregulli se përgjegjësia penale përcaktohet në momentin e kryerjes së veprës penale.

Në rastin konkret, i pandehuri në kohën e kryerjes së veprës penale ka qënë mbi 18 vjeç, dhe rrjedhimisht Gjykata, në vështrim të nenit **12/1 të Kodit Penal**, çmon se në drejtim të moshës i pandehuri, ka qënë madhore dhe e përgjegjshme penalisht në datën e kryerjes së veprës penale, objekt gjykimi dhe si e tillë ajo ka patur moshën për përgjegjësi penale. Gjithashtu, në çështjen objekt gjykimi nuk u provua që i pandehuri të vuajë nga ndonjë turbullim psikik ose neuropsikik që ka prishur tërësisht ekuilibrin e tij mendor dhe për pasojë nuk ka qënë në gjëndje të kontrollojë veprimet apo mosveprimet e tij dhe as të kuptojë se kryen vepër penale. Përkundrazi me veprimet e tij provohet që ai ka qënë i aftë të posedojë aftësi intelektuale dhe vultive për të kuptuar dhe vlerësuar sjelljen e tij dhe t’a kontrollojë atë. Në këto kushte, gjykata vlerëson se i pandehuri është subjekt i përgjegjshëm penalisht.

Sa më sipër u arsyetua, Gjykata vlerëson se nga mbi bazën e provave të administruara rezulton se provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se i pandehuri **Anteo Guci** e ka konsumuar figurën e veprës penale për të cilën akuzohet. Gjithashtu, Gjykata çmon se cilësimi juridik i bërë faktit penal nga prokuroria është i drejtë.

Në këtë mënyrë Gjykata arrin në konkluzionin se provohet përtej çdo dyshimi se i pandehuri **Anteo Guci** ka konsumuar në tërësi me sjelljen e tij të kundërligjshme anën objektive të veprës penale të prodhimit dhe shitjes së lëndëve narkotike të parashikuar nga neni 283 paragrafi i parë i Kodit Penal.

Përsa i përket kualifikimit ligjor të fakteve të parashtruara më sipër Gjykata vëren se neni 278/3/4 të K.Penal parashikon se :

“Mbajtja e armëve, e armëve shpërthyesë ose e lëndëve plasëse në automjete apo në çdo mjet tjetër të motorizuar, në mjedise publike ose në mjedise të hapura për publikun, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga pesë deri në shtatë vjet. Po kjo veprë, kur kryhet më shumë se një herë ose në sasi të mëdha, dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Mbajtja e municioneve luftarake, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.

Mbajtja e armëve në banesë, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga një deri në tre vjet.

Mbajtja e armëve shpërthyesë ose lëndëve plasëse në banesë, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga një deri në katër vjet.

Prodhimi, shitja, blerja, ofrimi për shitje, tregtimi dhe transportimi i armëve dhe i municioneve luftarake, lëndëve plasëse, i armëve shpërthyesë, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.

Po kjo veprë e parashikuar nga paragrafi i pestë i këtij neni, kur kryhet në sasi të mëdha, në bashkëpunim, më shumë se një herë ose ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Falsifikimi ose fshirja, zhvendosja ose ndryshimi i paligjshëm i shenjave mbi armët dhe municionet luftarake dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet”.

Për këtë veprë penale, **në lidhje me objektin e saj**, figura e krimit të mbajtjes pa leje të armëve luftarake është përfshirë në seksionin III të Kodit Penal “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike”. Në këtë kre është parashikuar si figurë e posaçme krimi në nenin 278/1 të Kodit Penal, prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve dhe e municioneve. Prandaj, objekt i kësaj vepre penale janë marrëdhëniet juridike të vendosura me ligj për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike në fushën e prodhimit dhe mbajtjes së armëve luftarake dhe të municionit, të mbrojtura posaçërisht nga legjislacioni penal. Këto veprime, për t’u cilësuar si veprë penale nga ligji duhet që arma dhe/ose municioni i mbajtur nga personi të jenë teknikisht të aftë për të realizuar qitje.

Në rastin konkret, ky objekt është cënuar nga i pandehuri **Anteo Guci**, pasi me veprimet e tij të drejtëpërdrejta dhe të vullnetshme, veprime të cilat do t’i analizojmë në analizë të anës objektive dhe subjektive të kësaj figure krimi, e ka kryer veprën penale.

Ana objektive e figurës së veprës penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”, parashikuar nga **neni 278 i Kodit Penal**, është element i domosdoshëm për përgjegjësinë penale, sepse pa veprim ose mosveprim të dënueshëm nuk ka veprë penale.

Në kuptim të nenit 278 të Kodit Penal, figura e veprës penale “*Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit*”, nga ana objektive kryhet në disa forma, të cilat janë:**a)** prodhimi i armëve luftarake dhe municioneve, lëndëve plasëse, i bombave apo minave pa lejen e organeve kompetente, që nënkupton prodhimin krejt të një arme zjarri apo municioni; **b)** mbajtjen e municioneve luftarake, pra e fishekëve pa lejen e organeve kompetente; **c)** mbajtja e armëve, i bombave apo minave ose lëndëve plasëse në banesë, në mjedise publike

ose në mjedise të hapura për publikun pa lejen e organeve kompetente shtetërore. Nga përmbajtja e paragrafit parë dhe tretë të neni 278 të Kodit Penal, rezulton se një element thelbësor i anës objektive është vendi dhe mjedisi ku mbahen armët. Sipas paragrafit të tretë të nenin 278 të Kodit Penal kërkohet që arma të mbahet në banesë, ndërsa sipas paragrafit të parë armët duhet të mbahen në mjedise publike ose në mjedise të hapura për publikun. Prandaj, Gjykata duhet të japë kuptimin e termit ligjor “banesë”, “mjedise publike” dhe “mjedise të hapura për publikun.”.

Gjykata vlerëson se, për të dhënë kuptimin e termit ligjor “banesë”, duhet të jap paraprakisht kuptimin e termit “mjedise publike” dhe “mjedise të hapura për publikun”. Gjykata vlerëson se, termi “mjedis publik” ka të njëjtin kuptim me termin “vend publik”. Në interpretim të frymës dhe përmbajtjes së nenit 278 të Kodit Penal me “mjedis publik” duhet kuptuar çdo mjedis që iu ofrohet për ta frekuentuar, vizituar apo përdorur publiku të gjerë (personave) pa asnjë kufizim dhe që këta të fundit mund të shkojnë atje lirisht dhe pa asnjë ndalim. Çdo mjedis tjetër, që kërkon leje, autorizim apo miratim paraprak apo të mëvonshëm, ku personi nuk mund të shkojë lirisht dhe nuk mund të përfitojë nga mundësitë që ofron ai mjedis, nuk mund të konsiderohet në kuptim dhe zbatim të drejtë të nenit 278 paragrafi parë i Kodit Penal si “mjedis publik”, por vetëm si “mjedis privat”. Mjediset apo vendet mund të jenë në pronësi të shtetit apo të personave fizik dhe juridik privat. Kështu, “mjedise të hapura për publikun” mund të jenë dhe ambjente që janë në pronësi private dhe përsëri mund të konsiderohet “mjedis i hapur për publikun”, siç mund të jenë qendrat tregëtare, lokalet e ndryshme, kazinot, shkollat private e ambjente të kësaj natyre. Gjykata çmon se, ligjvënësi në parashikimin si figurë më vete të mbajtjes së armëve në mjedise publike dhe në ashpërsimin e masës së dënimit, ka pasur parasysh faktin që mbajtja e armëve në ambjente të tilla, rrit probabilitetin si të përdorimit të tyre ashtu dhe të ardhjes së pasojave të rënda, pasi nga shtënia me armë në ambjente publike mund të vijë si pasojë vdekja ose plagosja e më shumë se një personi. Gjithashtu, duke pasur parasysh diferencat e mëdha të dënimit për personat që mbajnë armë në banesë me ata që i mbajnë armët në makinë, ambjente publike apo të hapura për publikun, gjykata vlerëson se, legjislatori ka dalluar esencialisht mbajtjen e armës për të mbrojtur banesën, pronën private dhe jetën e shëndetin e pjesëtarëve të familjes, nga mbajtja e armëve për qëllime kriminale në ambjente publike. Nënkuptimi i qëllimit vetëmbrojtës apo kriminal për mbajtjen e armëve të zjarrit është i vetmi shpjegim i arsyeshëm që justifikon dallime kaq të mëdha në marzhet e dënimit. Legjislatori e ka patur fare të qartë se arma është një send i lëvizshëm dhe transferimi i saj nga banesa në një ambjent publik nuk paraqet ndonjë vështirësi të madhe, për pasojë rrezikshmëria e saj si mjet është e njëjlojtë si në banesë si në ambjent publik. Ajo çfarë ia ndryshon substancialisht rrezikshmërinë mbajtjes së një arme zjarri është qëllimi përse ajo mbahet, nëse mbahet për mbrojtje apo mbahet për sulm.

Gjykata çmon se, me **“banesë” në kuptim të nenit 278 paragrafi i tretë të Kodit Penal, duhet kuptuar çdo ambjent tjetër që nuk hynë në “mjedise publike” apo “mjedise të hapura për publikun”.** Pra, nëpërmjet interpretimit të kundërt, me “banesë” do të kuptohet çdo mjedis që nuk iu ofrohet për ta frekuentuar, vizituar apo përdorur publiku të gjerë (personave) pa asnjë kufizim dhe këta të fundit s’mund të shkojnë atje lirisht dhe pa asnjë ndalim. Këtu, hynë ambjentet të tilla si: ndërtesat që përdoren për banim, oborri funksional i saj, tokat në pronësi private që janë të identifikueshme dhe të njohura nga personat e tjerë dhe që nuk mund të jenë të aksesueshme nga çdo person. Gjithashtu, Gjykata çmon se, sa herë që do të jemi përpara situatës nëse një ambjent do të konsiderohet publik apo privatë, e për rrjedhojë, fakti do të kualifikohet sipas paragrafit të tretë (mbajtja pa leje e armëve në banesë) apo sipas paragrafit të parë (mbajtja pa leje e armëve në mjedise publike) të nenit 278 i Kodit Penal, kjo do të interpretohet në favor të të

pandehurit. Kjo për këto arsye: *së pari*, sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së sa herë që jemi përpara kufizimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, duhet bërë interpretimi sa më i kufizuar i ligjit penal, ndërsa kur jemi përpara zgjerimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, duhet bërë interpretimi i zgjeruar. Ligji penal në vetvete sjellë si pasojë kufizimin e së drejtave dhe lirisë së personit. Në këto kushte, përderisa mbajtja e armëve luftarake në mjedise publike dënohet më shumë se mbajtja e tyre në banesë, Gjykata duhet të bëjë interpretim të ngushtuar të termit “mjedis publik” dhe interpretim të zgjeruar të termit “banesë”, kur një ambjent është i vështirë të kualifikohet në “banesë” apo “mjedis publik”. *Së dyti:* Gjykata duhet të ketë parasysh parimin e prezumimit të pafajësisë parashikuar në nenin 4 të K.Pr.Penale, ku parashikohet shprehimisht se: *“1. I pandehuri prezumohet i pafajshëm gjersa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë. Çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të të pandehurit.”*. Lidhur me kuptimin e këtij parimi, Gjykata Kushtetuese në vendimin Nr. 23, datë 23.07.2009, ndër të tjera shprehet se: *“Prezumimi i pafajësisë përbëhet nga disa aspekte, njëri prej të cilit është **in dubio pro reo**, pra çdo dyshim shkon në favor të të pandehurit dhe barra e provës bie kryesisht mbi organin e akuzës. Gjykata e ka interpretuar prezumimin e pafajësisë në kuptimin që gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet, se barra e provës i takon palës akuzuese, se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit, se gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që duhet të provohen nga akuzat.”*. Kur vihet në dyshim kualifikimi i faktit (akuzës) ky duhet bërë në favor të të pandehurit.

Në paragrafin e gjashtë të nenit 278 të Kodit Penal parashikohet kryerja e kësaj veprë në disa rrethana rënduese. Në këtë paragraf parashikohet se: *“Kur vepra penale kryhet në sasi të mëdha, në bashkëpunim, më shumë se një herë, ose ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet.”* Ligjvënësi, duke mos përcaktuar se cila do të konsiderohet “sasi e madhe” i ka dhënë të drejtë gjykatës që rast pas rasti ta vlerësojë në përputhje me rrethanat e çështjes. Për t’u vlerësuar si rrethanë rënduese në njërin prej formave të kryerjes së veprës penale të prodhimit apo të mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe të municionit në *“sasira të mëdha”* duhet të bëhet një vlerësim, para së gjithash, sasisë dhe cilësisë së armatimit luftarak të mbajtur nga subjekti. Në rastin e prodhimit të armëve si formë e kryerjes së veprës penale në çdo rast kemi të bëjmë me sasira të mëdha me qëllim nxjerrjen e përfitimeve. Në vlerësim të cilësisë së armëve duhet vlerësuar potenciali i tyre vdekjeprurës sipas përcaktimit të tyre në manualin ushtarak. Kjo vepër kryhet në bashkëpunim kur kryhet nga dy ose më shumë persona me marrëveshje midis tyre. Ndërsa ajo kryhet më shumë se një herë, kur ajo është kryer më parë dhe pas saj, kryhet edhe herë të tjera. Gjithashtu, kusht i domosdoshëm është që i pandehuri të mos ketë qënë dënuar më parë për ndonjë nga episodet për të cilën kërkohet të gjykohej, sepse ndryshe quhet përsëritës në kuptimin e nenit 50 të Kodit Penal. Po ashtu, në paragrafin e pestë parashikohet si rrethanë cilësuese *“Kur vepra penale ka sjellë pasoja të rënda”*. Për interpretimin e kësaj rrethane cilësuese, Gjykata mban parasysh qëndrimin e mbajtur nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me vendimin Nr. 6, datë 30.09.2011, ku ndër të tjera thuhet se: *“...pasoja e rëndë që parashikon neni 278/4 i K.Penal nuk ka kuptimin e një vrasjeje, apo dëmtimeve të tjera, por ajo ka kuptimin e pasojave të rënda që mund të vijnë si rezultat i shpërthimeve, ose i burimit të rrezikut të shtuar, prandaj vepra penale e mbajtjes pa leje të armëve luftarake, e kryer nga të gjykuarit duhet të cilësohet sipas nenit 278/2 të K.Penal.”*

Në rastin konkret, nga kontrolli i bërë në banesën e të pandehurit Anteo Guci, brenda janë gjetur një armë zjarri e llojit pistoletë, me mbishkrimin "Bloë Mind 2003, Nr. 6-221180 Cal 8 mm, 37

(tridhjetë e shtatë) fishekë të llojit të gjatë dhe të fabrikuar me kaliber 5,6 mm, të cilët përdoren si municion për gjitha armët e zjarrit sportive, 2 (dy) pranga të metalike, 5 (pesë) copë ndezes të unifikuar, në gjendjen që paraqiten janë teknikisht të parregullt. Per rrjedhoje ndezesat e kanë humbur aftësinë shpërthyes apo eksploduese, 1 (një) kreher pistolette.

Konkluzionet e aktit të ekspertimit tekniko balistik armë zjarri Nr 8295 të datës 24.08.2021 tregojnë se, arma e zjarrit objekt ekspertimi me numer 6-221180 e markes BLOË MINI MOD 2003, e sekuestruar shtetasit Anteo Guci, është arma zjarri pistoletë, e kalibrit 6,35 mm, që përdor si municion fisheke standarte luftarake të fabrikuar kaliber 6,35 mm. Në gjendjen që paraqitet është e përshtatshme për qitje.

Konkluzionet e aktit të ekspertimit tekniko balistik të provave materiale me Nr 345 të datës 16.08.2021 tregojnë se, municionet prej tridhjetë e shtatë copë fishekët objekt ekspertimi, janë fishekë luftarake model sportiv, të llojit të gjatë dhe të fabrikuar me kaliber 5,6 mm, të cilët përdoren si municion për gjitha armët e zjarrit sportive, pistoletat e këtij kalibri dhe janë në gjendje të rregullt dhe të përshtatshëm për qitje. Fishekët janë të ndryshëm në kalibër me atë të armës së zjarrit të sipërcituar.

Ndërsa konkluzionet e aktit të ekspertimit tekniko balistik të provave materiale me Nr 346 të datës 16.08.2021 tregojnë se, pesë copë ndezës objekt ekspertimi, janë ndezës të unifikuar të granatave të dorës, të cilat përdoren në granatat e luftimit mbrojtës e mësymës. Keta pesë copë ndezes të unifikuar, në gjendjen që paraqiten janë teknikisht të parregullt. Per rrjedhoje ndezesat e kanë humbur aftësinë shpërthyes apo eksploduese.

Pra, nga ana objektive, kjo vepër penale është konsumar me mbajtjen në banesën e tij të një arme zjarri pistoletë, e kalibrit 6,35 mm, si dhe 37 (tridhjetë e shtatë) fishekë të llojit të gjatë dhe të fabrikuar me kaliber 5,6 mm, të cilët përdoren si municion për gjitha armët e zjarrit sportive.

Ana subjektive e figurës së veprës penale, Gjykata vlerëson se ky element i figurës së veprës penale lidhet me qëndrimin psikik që mban personi kundrejt veprës së kryer prej tij. Ana subjektive karakterizohet nga dy elementë përbërës: Faji, pa të cilin nuk mund të ketë përgjegjësi penale. Ky element i përgjegjësive penale parashikohet shprehimisht në nenin 14 të Kodit Penal, ku thuhet: *“Askush nuk mund të dënohet për një veprim ose mosveprim të parashikuar nga ligji si vepër penale, në qoftë se vepra nuk është kryer me faj. Quhet me faj personi që e ka kryer veprën me dashje ose me pakujdesi.”* Pra, faji si element i domosdoshëm i përgjegjësive penale përmban në vetvete dy moment: *atë intelektual* dhe *atë që lidhet me vullnetin*. Momenti intelektual tregon nëse subjekti nga pikëpamja e ndërgjegjes ka qenë në gjendje të kuptonte karakterin e kundërligjshëm ose shoqërisht të rrezikshëm të veprës, të parashikonte ose jo ardhjen e pasojave të dëmshme, kurse momenti që është i lidhur me vullnetin tregon nëse ai dëshiron ose jo për të kryer një veprim të kundërligjshëm ose shoqërisht të rrezikshëm dhe nëse dëshironte ardhjen e pasojës. Në vartësi nga karakteri i këtyre dy momenteve, intelektual dhe vullnetiv, është e mundur të bëhet dallimi i dy formave të fajësisë, të dashjes e të pakujdesisë.

Gjykata vlerëson se, vepra penale **“Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit”**, parashikuar nga **neni 278 i Kodit Penal**, kryhet me dashjen e drejtëpërdrejtë. I pandehuri ka vepruar me dashje të drejtëpërdrejtë, pasi ka parashikuar karakterin shoqërisht të rrezikshëm të veprimeve të tij dhe ka mbajtur në banesë një arme luftarake dhe municionit në kuptim të ligjit **“Për armët”** (i ndryshuar në vitin 2014) i pa autorizuar nga organet kompetente shtetërore.

Në lidhje me subjektin e veprës penale, gjykata vlerëson se në rastin konkret plotësohet ky element, duke pasur parasysh nenin 12 të Kodit Penal, ku thuhet se “*Ka përgjegjësi penale personi që në kohën e kryerjes së një krimi ka mbushur moshën katërmëdhjetë vjeç. Personi që kryen një kundërvajtje penale ka përgjegjësi kur ka mbushur moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç*”. Kështu, personi fizik që të konsiderohet subjekt i figurës së veprës penale, dhe si rrjedhojë të plotësojë kushtin paraprak për fajin dhe përgjegjësinë penale, duhet të plotësojë dy kritere ekskluzive ligjore (*condicio sine qua non*): Të ketë mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe të jetë i përgjegjshëm. Kështu, neni 17 i Kodit Penal parashikon se: “*Nuk ka përgjegjësi penale personi që në kohën e kryerjes së veprës vuante nga një turbullim psikik ose neuropsikik që ka prishur tërësisht ekuilibrin e tij mendor dhe për pasojë nuk ka qënë në gjëndje të kontrollojë veprimet apo mosveprimet e tij dhe as të kuptojë se kryen vepër penale*” Ky kusht ka të bëjë me domosdoshmërinë për të proceduar penalisht vetëm personat e përgjegjshëm, që kanë të paktën një ndërgjegje minimale sa për t’i bërë ato të aftë të kuptojnë rëndësinë e veprimeve që kryejnë, në mënyrë që realisht të ekzistojë ana subjektive e autorit të veprës penale, që për organin procedues do të thotë të jetë i mundur të identifikohet forma e fajësisë. Megjithatë, që të përjashtohet nga përgjegjësia penale, për shkak të gjendjes mendore, duhet të plotësohen në mënyrë kumulative disa kushte. **Së pari:** personi të vuajë nga një turbullim psikik ose neuropsikik. **Së dyti:** ky turbullim të ketë prishur tërësisht ekuilibrin mendor të personit. **Së treti:** turbullimi të ketë ekzistuar në kohën e kryerjes së veprës. Ky kusht buron nga rregulli se përgjegjësia penale përcaktohet në momentin e kryerjes së veprës penale.

Në rastin konkret, i pandehuri në kohën e kryerjes së veprës penale ka qënë mbi 18 vjeç, dhe rrjedhimisht Gjukata, në vështrim të nenit **12/1 të Kodit Penal**, çmon se në drejtim të moshës i pandehuri, ka qënë madhore dhe e përgjegjshme penalisht në datën e kryerjes së veprës penale, objekt gjykimi dhe si e tillë ajo ka patur moshën për përgjegjësi penale. Gjithashtu, në çështjen objekt gjykimi nuk u provua që i pandehuri të vuajë nga ndonjë turbullim psikik ose neuropsikik që ka prishur tërësisht ekuilibrin e tij mendor dhe për pasojë nuk ka qënë në gjëndje të kontrollojë veprimet apo mosveprimet e tij dhe as të kuptojë se kryen vepër penale. Përkundrazi me veprimet e tij provohet që ai ka qënë i aftë të posedojë aftësi intelektuale dhe vultive për të kuptuar dhe vlerësuar sjelljen e tij dhe t’i kontrollojë atë. Në këto kushte, gjykata vlerëson se i pandehuri është subjekt i përgjegjshëm penalisht.

Sa më sipër u arsyetua, Gjukata vlerëson se nga mbi bazën e provave të administruara rezulton se provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se i pandehuri **Anteo Guci** e ka konsumuar figurën e veprës penale për të cilën akuzohet. Gjithashtu, Gjukata çmon se cilësimi juridik i bërë faktit penal nga prokuroria është i drejtë.

Akuza në ngarkim të të pandehurit **Anteo Guci** është provuar në seancë gjyqësore me administrimin në tërësi të akteve të ndodhura në **fashikullin e procedimit penal**, te cilat pasi u moren për shqyrtim, u administruan në dosje, duke zbatuar gjykimin e shkurtuar, dosja e prokurorit kthehet në dosje gjyqësore.

Lidhur me caktimin e llojit dhe masës së dënimit.

Gjukata para se të disponojë me dënimin penal, duhet të ketë parasysh parimet dhe kriteret e përgjithshme të caktimit të dënimit.

Gjukata vlerëson se dënimi penal është rezultat i vlerësimit të rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale nga njëra anë dhe shkallës së fajit të autorit të saj nga ana tjetër. Në këtë drejtim, Gjukata çmon se individualizimi i llojeve të dënimeve, rast pas rasti, është në diskrecion të gjykatës, e

cila duke shqyrtuar gjithë elementët juridikë të veprës penale, shkallën e fajit dhe pasojat e ardhura nga vepra penale, cakton llojin dhe masën e dënimit për autorët e veprave penale. Kështu, neni 47 i tij, nën titullin “Mënyra e caktimit të dënimit”, parashikon se “Gjykata cakton dënimin duke respektuar dispozitat e pjesës së përgjithshme të këtij Kodi dhe kufijtë e dënimeve të parashikuara në ligj për veprën penale. Në caktimin e dënimit ndaj personit ajo merr parasysh rrezikshmërinë e veprës penale, të autorit të saj, shkallën e fajit, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese.” Në këtë dispozitë është shprehur parimi i individualizimit të dënimit, i cili është një nga parimet themelore që udhëheq gjykatën në caktimin e dënimit. Kjo është arsyeja pse ligjvënësi për çdo vepër penale të veçantë ka parashikuar marzhet minimum dhe maksimum për dënimin e veprës penale. Pikërisht ky limit do të jetë hapësira e gjykatës për të vlerësuar masën e dënimit.

Një nga kriteret që mban parasysh gjykata në caktimin e dënimit është rrezikshmëria e vepres penale. Për të interpretuar “rrezikshmërinë e veprës penale” është e nevojshme, që në kuadrin e praktikës gjyqësore dhe të një të “drejte gjyqësore” tashmë të formuar prej vitesh në traditën juridike të Republikës sonë, t’i referohemi në mënyrë orientuese Udhëzimit Nr. 2, datë 14.03.1979 të Pleniumit të Gjykatës së Lartë, i cili përmban vlera të pamohueshme interpretative, ku përcaktohen elementët individualizues dhe matës të rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale. Këto element, në mënyrë të hapur listuese dhe orientuese, janë: a) Objekti; b) Vendi; c) Koha; d) Gjendja në të cilën kryhet vepra penale; e) Nëse vepra penale është e përhapur në atë rreth; f) Rrethanat që kanë ndikuar në kryerjen e saj.

Në lidhje me rrezikshmërinë e figurave të veprave penale “**Prodhimi dhe shitja e narkotikeve**”, “**Mbajtje pa leje dhe prodhimi i armeve, armeve shperthyese dhe i municionit**”. Përcaktimi i rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale lidhet gjithmonë me natyrën dhe llojin e saj, me masat e dënimit që përcakton neni përkatës, me përhapjen, pasojat që ka sjellë. Gjykata thekson se kjo vepër përbën krim dhe paraqet rrezikshmëri relativisht të lartë shoqërore, për të cilën ligjvënësi parashikon dënimet *e përshkruara më lart*. Këto vepra penale kanë marrë një përhapje shumë të gjerë në komunitetin tonë. Pra, rrezikshmëria shoqërore e këtyre veprave, në kushtet aktuale është e lartë duke parë tendecat e rritjes të këtyre veprave penale, jo vetëm në gjithë territorin e Republikën së Shqipërisë, por edhe përhapjen e kësaj veprave penale në rrethin e Tiranës. Prandaj, në caktimin e dënimit gjykata duhet të ketë parasysh funksionin e parandalimit të përgjithshëm në kryerjen e kësaj veprave penale.

Gjithashtu, për interpretimin e “rrezikshmërisë së autorit të saj” është e nevojshme të përmendim disa elementë orientues për t’u mbajtur parasysh, që Udhëzimi i mësipërm identifikon si: a) Gjendja sociale; b) Profesionin; c) Arsimimi; d) Gjendja familjare; e) Gjendja gjyqësore. Interpretuar në harmoni të gjithë këto tregues, ansambël rrethanash objektive dhe subjektive që kanë lidhje të drejtëpëdrejtë me personalitetin dhe individualitetin që paraqet individi në shoqërinë tonë, japin konkluzionin se i pandehuri paraqet rrezikshmëri shoqërore të ulët ose të lartë. Prandaj, për gjykatën lind detyrimi që në çdo çështje të analizojë faktorët apo tiparet e personalitetit të autorit të veprës penale. Kjo për faktin, pasi për arritjen e qëllimit të parandalimit të posaçëm është e nevojshme që dënimi t’i përshtatet personalitetit të fajtorit d.m.th t’i përshtates tërësisë së karakteristikave individuale të tij, që përbëjnë fizionominë e tij politiko shoqërore. I pandehuri nuk është dhe nuk mund të shikohet si figurë abstrakte, por si një njeri i gjallë me cilësi të caktuara, me një të kaluar dhe me një prespektivë të caktuar. Sipas të drejtës tonë penale vepra penale përbën një unitet të elementëve objektiv dhe subjektivë dhe në shkallën

e rrezikshmërisë shoqërore të vepërës influencojnë në shumë raste rrethanat që karakterizojnë të pandehurin, cilësitë e subjektit të krimit.

Zhvillimi mendor, karakteri dhe gjendja e ndërgjegjes së autorit kanë rëndësi për trajtimin penal të tij. Në çmuarjen e personalitetit të të pandehurit duhet të merret parasysh moshë si tregues kryesor i pjekurisë mendore, sjellja e tij e mëparshme, sjellja pas kryerjes së veprës penale, pendimi dhe gadishmëria për të riparuar pasojat e veprës penale. Gjithashtu, duke u nisur nga këto tipare, duhet konstatuar se çfarë përfaqëson për të pandehurin vepra penale që ai ka kryer, është ajo pasojë llogjike e botkuptimit, karakterit dhe prirjeve apo ajo nuk përfaqëson thelbin e cilësive dhe tipareve të tij, por është një akt i pamenduar mirë, një reagim në rrethana konkrete të rastit. Prandaj, në çdo çështje konkrete, gjykata, duhet të hetojë lidhur me personalitetin e të gjykuarit. Kjo për faktin pasi mënyra e reagimit të autorëve ndaj dënimit ose ndikimi që mund të ushtrohet mbi këtë me anë të dënimit është i ndryshëm.

Në lidhje me këtë kriter, për të pandehurin **Anteo Guci**, Gjykata në rastin konkret mban parasysh disa fakte. Së pari: personalitetin e të pandehurit, të kaluarën e tij kriminale, ku nga vërtetimi mbi gjendjen gjyqësore rezulton se i pandehuri është i padënuar me pare. Së dyti, gjendjen familjare të të pandehurit, i cili rezulton të jetë i martuar me 2 fëmijë. Së treti, moshën e të pandehurit i vitlindjes 1983. Së katërti, arsimin e të pandehurit, i cili është me arsim të mesëm, si dhe faktin që i pandehuri e pranon akuzën dhe shfaq pendese.

Shkallën e fajit. Në lidhje me këtë kriter, nga tërësia e të gjithë veprimeve të të pandehurit, Gjykata thekson se ato janë kryer në formën e dashjes direkte, formë e cila përbën edhe shkallën më të lartë të fajit, pasi ai ka parashikuar karakterin shoqërisht të rrezikshëm të veprimeve të tij dhe ka vepruar në mënyrë të kundërligjshme e të vullnetshme.

Në lidhje me rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Në caktimin e masës së dënimit kundër autorit të vepërës penale penale konkrete, gjykata mban parasysh, ndër të tjera, rrethanat rënduese dhe lehtësuese, të cilat janë faktorë të ndryshëm objektive dhe subjektivë që tregojnë për një shkallë rrezikshmërie më të ulët ose më të lartë të veprës dhe të fajtorit. Gjykata, në çështjen objekt gjykimi mban parasysh faktin që ndaj të pandehurit nuk konstatohet asnjë rrethanë rënduese nga ato të parashikuara nga neni 50 të Kodit Penal.

Sa më sipër, duke analizuar në kompleksitet të gjitha rrethanat e përmendura më sipër, Gjykata çmon se, i pandehuri paraqet rrezikshmëri shoqërore të tillë, e cila e bën të nevojshme dhe të domosdoshme që gjykata të japë një masë dënimi me burgim ndaj tij. Për rrjedhojë, mbështetur në nenet 47-50 të Kodit Penal Gjykata çmon se, i pandehuri **Anteo Petrit Guci** duhet të deklarohejt fajtor për veprën penale “**Prodhim dhe shitje e lendeve narkotike**” dhe në bazë të nenit **283/1 të K.Penal** dënimin e tij me **5 (pesë) vjet burgim**, për veprën penale “**Mbajtje pa leje dhe prodhimi i armëve, armeve shperthyese dhe i municionit**” dhe në bazë të nenit **278/3 të K.Penal** dënimin e tij me **1 (një) vit burgim**, për veprën penale “**Mbajtje pa leje dhe prodhimi i armëve, armeve shperthyese dhe i municionit**” dhe në bazë të nenit **278/4 të K.Penal** dënimin e tij me **1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj burgim**. Në zbatim të nenit 55 të K.Penal, në bashkim të dënimeve e dënon të pandehurin **Anteo Petrit Guci** me një dënim të vetëm prej **6 (gjashtë) vjet burgim**. Në zbatim të nenit 406 të K.Pr.Penale i ulet 1/3 e masës së dënimit duke e dënuar përfundimisht të pandehurin **Anteo Petrit Guci** me **4 (katër) vjet burgim**

Por Gjykata çmon të pershtatshme për këtë të pandehur aplikimin e nenit 59 të K.Penal.

Kriteret ligjore për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim, janë të parashikuara në nenin 59 të KP, i cili sanksionon:

“Per shkak te rrezikshmerise se pakët te personit, moshës, kushteve shendetesore apo mendore, menyres se jeteses apo nevojave, vecanerisht atyre qe lidhen me familjen, shkollimin ose punen, rrethanave te kryerjes se vepres penale si dhe sjelljes pas kryerjes se vepres penale gjykata kur jep denimin me burg deri ne pese vjet mund te urdheroje qe i denuari te mbaje kontakte me sherbimin e proves dhe te vihet ne prove duke pezulluar ekzekutimin e denimit me kusht qe gjate kohes se proves te mos kryeje veper tjeter penale”.

Pezullimi i ekzekutimit te vendimit me burgim dhe venia ne prove e autorit te vepres penale perfshihet ne kategorine e alternativave te denimit me burgim, qe ne konceptin e politikës penale synon te zgjeroje mundesitë e edukimit dhe rehabilitimit ne shoqëri të personit qe ka kryer veprën penale ne forma te ndryshme nga ajo e kufizimit te lirisë së tij personave.

Mundesia ligjore e zbatimit të nenit 59 të Kodit Penal kufizohet vetem brenda kriterëve te parashikuara nga kjo dispozite, të cilat ne thelb lejojne këtë alternative dënimi vetëm për shkaqe te posacme, të lidhura me personalitetin e autorit të veprës penale, moshën e tij, kushtet shëndetësore e mendore, nevojat familjare, ato të punës dhe të shkollimit.

Rrethanat e lartpermendura në radhë të parë diktojnë domosdoshmërine e edukimit të autorit të vepres penale jashtë institucionit të vuajtjes së denimit, per të garantuar permbushjen e nevojave të tij familjare dhe së dyti vleresohet si një mundesi potenciale vetem per personat që për shkak të rrezikshmerise së paket shoqerore, të reflektuara në menyren e kryerjes së vepres penale, sjelljen e meparshme ose pas kryerjes së vepres penale krijojne garanci per rehabilitimin e tyre dhe brenda mjedisit familjar e shoqeror dhe nën mbikqyrjen e sherbimit të proves.

Nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqesor Gjykata çmon se, pezullimi i ekzekutimit të denimit me burgim, justifikohet duke marre parasysh personalitetin e të pandehurit, rrezikshmerine e tij të vogel shoqerore referuar sasisë së vogël të lëndës narkotike si dhe faktin se dy veprat e tjera penale paraqesin rrezikshmëri të pakët shoqërore referuar dispozitave përkatëse dhe marzhit të dënimit, ku njëra është kundravajtje penale dhe tjetra parashikon dënim deri në tre vjet burg, moshen e tij, menyren e jeteses dhe të nevojave të tij të punësimit, si dhe rrethanat e kryerjes së vepres penale. Gjykata ka parasyshë faktin se është kyefamiljarë dhe se ka dy fëmijë të mitur të datëlindjes 2011 e 2017, ka nje femije te semure Helios Guci qe vuan nga crregullim te renda psikologjike dhe qe ka nevoje per prezencën e figures aterore, nevojat e tij të punësimit dhe sjelljen e tij pas kryerjes së vepres penale pasi shfaqë pendesë në seancë gjyqësore.

Sa me lart, Gjykata konkludon se ne kushtet kur denimi i caktuar ndaj te pandehurit **Anteo Guci** eshte deri në **4 (katër) vjet** dhe ekzistojne disa prej kriterëve te sanksionuara ne nenin **59 te Kodit Penal** duhet te urdherohet pezullimi i ekzekutimit te denimit me burgim dhe venia ne prove e te pandehurit per nje periudhe prej **5 (pesë) vjet**, sipas nenit **59/3 i Kodit Penal, ndryshuar me ligjin nr.36/2017**, i cili parashikon që *“Për dënimet e dhëna deri në dy vjet burgim, të pezulluara nga gjykata, afati i provës është sa dyfishi i kohës së dënimit me burgim të dhënë nga gjykata”*, gjate te ciles ai nuk duhet te kryeje asnje veper tjeter penale.

Në zbatim të neneve 59 dhe 61 të K.Penal urdhërohet i pandehuri **Anteo Guci** të paraqitet rregullisht dhe të informojë në vazhdimësi Shërbimin e Provës për përmbushjen e detyrimeve të mësipërme.

Duke qenë se i pandehuri **Anteo Guci** u deklarua fajtor dhe u dënua për veprën penale për të cilën akuzohet, bazuar në nenet 393 e 485 të K.Pr.Penale, i pandehuri detyrohet të paguajë shpenzimet proceduriale të kryera në fazën e hetimeve paraprake, si dhe shpenzimet gjyqësore.

PER KETO ARSYE

Gjykata bazuar të nenet 384 e 390 te Kodit të Procedurës Penale

VENDOSI

1. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Anteo Petrit Guci** për veprën penale “**Prodhim dhe shitje e lendeve narkotike**” dhe në bazë të nenit **283/1 të K.Penal** dënimin e tij me **5 (pesë) vjet burgim**.
2. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Anteo Petrit Guci** për veprën penale “**Mbajtje pa leje dhe prodhimi i armëve, armeve shperthyese dhe i municionit**” dhe në bazë të nenit **278/3 të K.Penal** dënimin e tij me **1 (një) vit burgim**.
3. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Anteo Petrit Guci** për veprën penale “**Mbajtje pa leje dhe prodhimi i armëve, armeve shperthyese dhe i municionit**” dhe në bazë të nenit **278/4 të K.Penal** dënimin e tij me **1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj burgim**.
4. Në zbatim të nenit 55 të K.Penal, në bashkim të dënimeve e dënon të pandehurin **Anteo Petrit Guci** me një dënim të vetëm prej **6 (gjashtë) vjet burgim**.
5. Në zbatim të nenit 406 të K.Pr.Penale i ulet 1/3 e masës së dënimit duke e dënuar përfundimisht të pandehurin **Anteo Petrit Guci** me **4 (katër) vjet burgim**.
6. Në zbatim të nenit 59 të K.Penal (**ndryshuar me ligjin nr.36/2017**) të pezullojë ekzekutimin e dënimit me burgim për të pandehurin **Anteo Petrit Guci** duke e vënë të pandehurin në provë për një afat **5 (pesë) vjetesh**, me kusht që gjatë kësaj kohe të mos kryejë veprë tjetër penale.
7. Në zbatim të neneve 59 dhe 61 të K.Penal urdhërohet i pandehuri **Anteo Petrit Guci të paraqitet rregullisht që nga dita e nesërme e shpalljes dhe të informojë në vazhdimësi Shërbimin e Provës** për përmbushjen e detyrimeve të mësipërme.
8. Sendet e sekuestruara me procesverbalin e dates 05.08.2021, te cilat jane “Ndezës granate dore, 5 cope, arme zjarri pistolete e markes BLOË MINI MOD 2003, kalibri 6.53 mm, 1 cope, Fisheke luftarake, model sportiv, te gjate, kaliber 5.6mm, 37 cope, te kalojne ne favor te shtetit.
9. Asgjesimin e lendes narkotike, sekuestruar me procesverbalin e dates 05.08.2021.
10. Ne zbatim te nenit 389 te K.Pr.Penale shuarjen e mases se sigurimit personal “**Arrest ne shtepi**”, parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale, te caktuar ndaj te pandehurit **Anteo Petrit Guci** me vendimin per caktim mase sigurimi me **nr.1342/1 Akti dt.30.09.2021**, te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.
11. Shpenzimet e kryera gjatë hetimeve paraprakë dhe ato gjyqësore në ngarkim të të pandehurit.
12. Kundër vendimit lejohet ankim brënda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve duke filluar nga e nesërmja e njoftimit te ketij vendimi në Gjykatën e Apelit Tirane

U shpall në Tirane sot me **datë 04.03.2022**.

SEKRETAR
REI PEÇI

GJYQATAR
LAZER SALLAKU

Shpenzime proçeduriale te prokurorise 11000 Leke.

Shpenzime te gjykimit nuk ka.